

Data ___ / ___ / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rehabilitimi i fasadave dhe rrugës Luigj Gurakuqi deri te sheshi Avni Rustemi (me parkim dy kate nën tokë)”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 695,452,085.17 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e pesë pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **6,780,929 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) Euro.**

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26/ 03/ 2024 është 102.56 Lekë/Euro.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,390,904,170** (një miliard e treqind e nëntëdhjetë milion e nëntëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kruen V, Seksioni III, Neni 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **347,726,043** (treqind e dyzetë e shtatë milion e shtatëqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyzetë e tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **1,390,904,170** (një miliard e treqind e nëntëdhjetë milion e nëntëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 347,726,043 (treqind e dyzetë e shtatë milion e shtatëqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyzetë e tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 1,390,904,170 (një miliard e treqind e nëntëdhjetë milion e nëntëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar

(ku percaktohet ndarja e perqindjeve). Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet qe ne rastet e BOE apo Nenkontraktim, vleresimi i pervojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit; me marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore qe parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos ne kushte te barabarta dhe u jep mundësi te gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vleresimit mund te jene te paplotesuara sipas standartit.

AK ka kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera percaktohet se: ***Në rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gjermimi në tokë.
- NP-2 E Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-3 C Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada.
- NP-4 B Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- NP-7 A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- NS-4 C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
- NS-6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS-9 D Punime strukturorë speciale.
- NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS-12 B Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit
- NS-18 A Punime topogjeodezike
- NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1 A	Punime germimi ne toke	<i>Emërtimi i Punimeve</i>	0-20 milion
		<ul style="list-style-type: none"> • Germim dheu kat I-re me skreper, L=100m dhe V=6~6.5m³ • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m³,shkarkimi ne auto • 	<p>Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve</p> <p>6,098,265</p>
NP-2 E	Ndërtime civile dhe industriale	<ul style="list-style-type: none"> • Nenshtrese zhavori • Shtrese betoni C 12/15 • Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37 • Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 8m • Trare e arkitrare b/a C30/37 h ~ 4m • Soleta te plota b/a C 30/37 t = 10 cm, h ~ 4m • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 (perde betoni) • Soletë BA me ngjyre • Çmontim + transport konstruksione metalike të përbëra • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm • F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm • F V konstruksione metalike te perbera 	<p>201-400 milion leke</p> <p>Vlera e punimeve e parashikuar ne preventiv</p> <p>215,979,043.3</p>

NP-3 C	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada.	<ul style="list-style-type: none"> • Prishje suvaje me pastrim • Cmontim dritare/vetrata te amortizuara • Prishje shtresash fasade • Prishje shtresash tarrace • Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjete + suva. • Boje hidroplastike importi cilesi e I-re • Boje vaji siperfaqe metalik • F V dritare d/alumini plastike me dopio xham • F V vetrata d/alumini plastike me dopio xham • F V dyer d/alumini plastike me dopio xham • H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum ne tarrace • Veshje fasade me pllaka mermeri • Davancal mermeri per dritare • Pllake b/a granili mbi parapet tarace • Veshje kornize llamarine xingat • Hapesire reklamimi • Kasete shkarkimi me llamarine xingat • Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm • F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion mesatare per kondicioneret • F.V tenda hijezuese • F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion mesatare per kondicioneret 	<p>51-100 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>90,287,066.8 8</p>
NP-4 B	Rrugë , autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> • Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri • Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri • Shtrese stabilizant t=15cm • Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri • Struktura monolite betoni C 16/20 (kuneta) • F V bordura betoni 10x25cm • F V bordura betoni 20x35 cm (kondra bordurat, perfshire llacin per fiksimin e bordures) • Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka (perfshire llacin per fiksimin e pllakes dhe zhavorr 7cm) si Pazari Ri • Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (trotuar me pllaka) • Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 5cm, me makineri (sheshi+trotuar) • Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri • Shtrese stabilizant t=10cm (sheshi+trotuar) • Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (sheshi+trotuar) 	<p>21-50 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>48,443,470</p>
NP-7 A	Ujësjetës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	<ul style="list-style-type: none"> • F.v tubacione PE-XB/AL-HDPE I izoluar • F.v tubacione PE-XB/AL-HDPE I izoluar • F.v brryla 900 bronxi • F.v brryla 900 bronxi • F.v brryla 900 te thjeshte • F.v brryla 900 te thjeshte • F.v ti PE-XB/AL-HDPE • F.v ti PE-XB/AL-HDPE 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve 11,535,274</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • F.v bashkuese PVDF • F.v bashkuese PVDF • F.v Kolektor 1 1/4" me 15 dalje me aksesore dhe kaseten • F.v Kolektor 1 1/4" me 19 dalje me aksesore dhe kaseten • F.v Kolektor PP-R dn75 me 8-te dalje dn32 I pajisur me kasete dhe rakorderi • F.v Kolektor PP-R dn75 me 4-te dalje dn32 I pajisur me kasete dhe rakorderi • F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Tuba celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • "F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim, • 90" • "F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim, • 90 "F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim, • 90" • "F.v Brryla celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim, • 90" • F.v Ti celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Ti celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Ti celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Niples celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Niples celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Niples celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • F.v Niples celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me filetim • "F.v Reduksion celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me • filetim" • "F.v Reduksion celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me • filetim" • "F.v Reduksion celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me • filetim" • "F.v Hollandez celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me • filetim" • "F.v Hollandez celik I zinguar si UNI-8863, tipi i 	
--	--	---	--

		<p>mesem me</p> <ul style="list-style-type: none"> • filetim" • "F.v Hollandez celik I zinguar si UNI-8863, tipi i mesem me • filetim" • F.v Saracineske bronzi me sfere • F.v Saracineske bronzi me sfere • F.v Reduktues presioni • F.v Sahat mates uji, Dn 75 mm + flanaxhat dhe askesore • F.v Valvulmoskthimi • F.V. Tub dhe rakorderi PP-R Dj 16 mm PN 10 bar • F.V. Tub dhe rakorderi PP-R Dj 20 mm PN 10 bar • F.V. Tub dhe rakorderi PP-R Dj 32 mm PN 10 bar • F.v Valvulmoskthimi • F.v Ene zgjerimi 150 litra + aksesoret per montim • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Brage polipropileni C(me guanicion plastik) • F.v Brage polipropileni C(me guanicion plastik) • F.v Brage polipropileni C(me guanicion plastik) • F.v Bryla polipropileni 45°(me guanicion plastik) • F.v Bryla polipropileni 45°(me guanicion plastik) • F.v Bryla polipropileni 90°(me guanicion plastik) • F.v Bryla polipropileni 90°(me guanicion plastik) • F.v manikote wc • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H30 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H35 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H40 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H45 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H50 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H55 cm • Pusetë zgarë GS 40 x 40 x H60 cm • Pusetë zgarë GS 50 x 50 x H70 cm • F.V TUB HDPE Dj 125 mm SDR 26, p = 0.5 cm/m • F.V TUB HDPE Dj 160 mm , p = 0.5 cm/m • F.V TUB HDPE Dj 200 x 6.2 mm, p = 0.5 cm/m • TUB PP Dj 50 mm p = 0.02 m/m • TUB PP Dj 110 x 3.4 mm p = 0.02 m/m • F.v Pilete dyshemeje • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Bryla polipropileni 45°(me guanicion plastik) • F.v Brake polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Brake polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Reduksion polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Doppio manikote per zgjatimet termike • F.V. tub korrugato drenazhi, d=200 mm • Mbushje me cakell pas mureve 	
--	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Gjeotekstil me gramature 180 g/m² • F.v. puseta betoni 40x40x H cm me kapak betoni • F.V.pusete 100x100x440cm • Mbushje me zhavorr • Pusete shiu 40 x 70, h ~ 150 cm, me kapak kompozit • Shirit Sinjalizues • F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm (perfshire reren rreth tubit) • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Tubacion polipropileni me gomina • F.v Bryla polipropileni 45°(me guanicion plastik) • F.v Brake polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Brake polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Reduksion polipropileni (me guanicion plastik) • F.v Dopio manikote per zgjatimet termike 	
NP-11 A	<p>Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • FV Paneli DB Main • FV Paneli DB-B1 • FV Paneli DB-SC • FV Paneli DB-Komandimit • Aksesore per tensionin e ulet dhe dhomat elektrike • Kabllot e Fuqise • FV Kabell Fuqie NYY 0.6/1kV (1x150 mm²) • FV Kabell Fuqie NYY 0.6/1kV (1x120mm²) • FV Kabell Fuqie NYY 0.6/1kV (5x16 mm²) • FV Kabell Fuqie FG100M1 0.6/1kV (5x35 mm²) • "Sistem Kanalina Metalike I kompletuar me te gjithë aksesoret • per montim dhe e gatshme per perdorim." • FV Kanaline 100 mm gjeresi (60 mm lartesi) me vrima • FV Kanaline 300 mm gjeresi (60 mm lartesi) me vrima • FV Kanaline 100 mm gjeresi (60 mm lartesi) ngritese • FV Kanaline 200 mm gjeresi (60 mm lartesi) ngritese • FV Kanaline 300 mm gjeresi (60 mm lartesi) ngritese • Tuba instalimesh elektrike • FV Tub Plastik Ø 20 mm me aksesore • FV Tub Fleksibel Ø 25 mm me aksesore • Pajisje Elektrike • "FV Prize Shuko Dyshe (e kuqe) per montim ne kanaline • plastike" • FV Prize Shuke Dyshe (e bardhe) per montim ne kanaline plastike • FV Kanaline Plastike 160x60mm (2 ndarje) me aksesore • 5-6W LED IP20 150x4xh=45 • F.v. Tabele drejtkëndore (tregimi)(AxB) e zvogëluar 40x60 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve 6,5494,849</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40w, • Ndricues tip plafoniere, emergjence,1x18w,IP65 • Sensor parkimi • F.V priza shuko "Gevis" universal • F.V Kuader ndricimi • F.V Kuti derivacioni plastike • F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis" • F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x1.5 mm2 • F.V. Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm ,;K.Z. FG7-OR ; S=3x2.5 mm2 • 	
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> • Nivelim dhe rrafshim siperfaqe • Perpunim dhe pasqyrim dheu me humus 100kg/m3 • F.V. Humus • Heqje pemesh ekzistuese • F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander" • F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 3,011,839
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Skarifikim shtrese asfalti me makineri • Punime prishje shtresash trotuari • Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri • Prishje shtresa betoni • Heqje bordurash betoni • Prishje struktura prej betoni • Prishje struktura prej betoni 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 3,354,130
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> • F.v Lavaman porcelani me kollone + mishelator te kromuar • F.v WC allafrenga me flusometer • F.v Wc Per Paraplegjik • F.v Lavaman Per Paraplegjik • F.v Boiler elektrik 30 litra • F.v Rezervuar celik i zinguar V=5000 litra+ aksesoret • "F.v Grup elektropompash me q=6.2 l/s dhe H=3 bar se bashku me aksesoret" • F.v Grup elektropompash zhytese 1+1,Q=4,6 l/s; H=10m(me gjit 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 1,673,327.00
NS-3 A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	<ul style="list-style-type: none"> • Ashensor 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 2,800,000

<p>NS-4C</p>	<p>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mur me tulle me 6 vrima, t=12cm, h~3m, llaç perzier M15 • F.V.membrane hidroizoluese vetngjitese, t=1.5mm, muret • F.V. flete mbrojtese dhe drenazhuese HDPE, t=8mm • F.v.flete polietileni nen themele • F.v. shirit waterstopi gjeobentoniti, themel-mur • Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 • "Pllakë shtrimi, Vitale Pearl, • porcelan, 60x120 cm • ne siperfaqet nen 240 cm te tualetit" • Lyrje me boje RAL 9003 • Veshje me pllaka qeramike 30x60cm ne tualete • Hidroizolim me dy shtresa mapej tualete ballkone • Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm • Hidroizolim me emulsion bitumi me 2 shtrese katrama • Rezine e ngjyrosur dhe autonivelant 3 cm • Shtrese betoni te lehtesuar 7 cm • Shtrese me granil 5-12 cm • Shtrese lluster cemento 4 cm • Shtrese hidroizoluese Volgrip(themeli) • F.V dyer metalike me llamarine te zeze me boje te pjekur • F.V dyer kundra zjarrit • F.V. dyer HPL ne tualete • F.V. ndarje me HPL • "Grilë ajrimi, alumin, me fletë të lëvizëshme manualisht" • "Grilë ajrimi, alumin, me fletë të palevizshme" • Parapet shkalle e ballkone me tuba xingato, h=50cm • F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 mm • F.v.tubo plastike Ø 80mm • Kanaleta plastike me zgare inoksidabel 10x10cm • Kanaleta plastike me zgare gize10x20cm • F V tub drenazhi Ø 150 mm • Vizime me boje epokside ne dysHEME • Bojatisje me boje betoni plintuse • Xhunto diletacioni gome ne dysHEME, t=10cm • F,V, fuge llamarine xingato ne mure, t=0.8mm, b=24cm • Boje hidroplastike importi cilesi e I-re • Xhunto diletacioni ne solete me Mapeband TPE 325, ngjitje me resine epokside 	<p>51-100 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>61,946,164</p>
<p>NS-5 A</p>	<p>Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • F.V semafor automjetesh (rrjeta+shtylla+ndriçues+paisje komandimi • F.V semafor kembesoresh • "FV Autoparlanti 100V/6W ne mur / tavan per sistemin e • Evakuimit" • "FV Kabell rezistent ndaj zjarrit FE90/E30 - 	<p>0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>4,430,506</p>

		<ul style="list-style-type: none"> Kabell autoparlanti • 2x2.5mm²" • FV Tub plastik Ø20mm duke perfshire aksesoret • FV Kontrollues me 4-6 zona • Izolim rezistent ndaj zjarrit per hapjet ne mur • Aksesore instalimi • "FV Njesi sherbimi ne dhome me llambe sinjalizuese te • integruar dhe me sinjalizim zanor" • FV Modul sinjalizimi elektronik qe perfshin nje llambe sinjalizuese • FV modul thirrjeje me celes me terheqje dhe llambe sigurimi • FV modul resetimi (buton me shtypje per anulim) • FV furnizim me energji emergjence 24V/1A • FV Kabell JY-(St)-Y 2x0.8 mm² • FV Kabell JY-(St)-Y 2x2x0.8 mm² • FV Kabell NYM 3x1.5 mm² • FV Tub plastik Ø20mm • Aksesore instalimi 	
NS-6 A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	<ul style="list-style-type: none"> • Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (paste) • Boje bikomponente (paste) • Tabele katërkëndore "shërbimi" normal 60x90 • FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm • Sinjale "emër rruge" LxH e vogël 80x20 • Tabela trekendore e vogel me A = 60 • Tabela me shenja sigurie • FV Tabele per tregimin e vendeve te lira dhe te zena • Tabela me shenja sigurie 	0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 6,255,205
NS-9 D	Punime strukturorë speciale.	<ul style="list-style-type: none"> • Trarë pilotash b/a C 25/30 monolit • Pilota B/A C25/30 Ø80cm, ~25m • Çmontim + transport konstruksione metalike të përbëra • Ngulja e pilota me ekskavator batipal • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - pilotat • F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm - pilotat 	101-200 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 103,391,277
NS-12 B	Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionimit	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i Detektimit te CO • FV Paneli i Detektimit te CO me 4 loop (4 zona) • FV Sensor Detektimi te CO • FV Sensor Detektimi te NO • FV Kabell JY-(St)-Y 2x2x0.8 mm² • FV Tub rigjid Ø 20 mm me aksesore • Furnizimi I Sistemit te Ventilatoreve • FV Paneli SB-VENT • FV Kabell FTG10OM1 4x1.5mm² per ventilatoret • FV Kabell FTG10OM1 1x150mm² • FV Kabell FG70HH2R 3x16mm² + ekran • FV Kapese metalike per kablllo rezistente ndaj zjarrit 	21-50 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 49,958,177.25

		<ul style="list-style-type: none"> • Aksesore instalimi • F.Ventilator aksial per objekte me rrezik zjarri Q =87000 m³/h • F.Ventilator centrifugal me reze te gjate Q =6050 m³/h. X=46 m • Aspirator 90 m³/h,Ø100 • "FV Panel kontrolli i alarmit te zjarrit i adresueshem per 2 loop me 127 pajisje te adresueshme per cdo loop me panel ballor per operim, karikuesi dhe bateria te perfshira ne panel, suporton vendosjen ne rrjet te panelit me fiber optike dhe lidhje me stacionin e monitorimit. Nderfaqe te integruara per operimin e panelit te brigades se zjarrit" • FV Kombinator telefonik • FV Detektor optik tymi I adresueshem me izolator te integruar dhe baze normale • "FV Indikator ne distance per detektor tymi mbi tavane te • varuara" • FV Pulsant alarmi zjarri I adresueshem • FV Sirene e adresueshme me sinjalizues me drite • FV Transponder I adresueshem - 4 inpute / 4 outpute • FV Transponder I adresueshem - 2 inpute / 2 outpute • FV Furnizim me energji me bateri, karikues 2A/24VDC 7Ah • FV Furnizim me energji me bateri, karikues 2A/12VDC 7Ah • "FV Kabell rezistent ndaj zjarrit FE180/E30 - 2x0.8mm me • mbrojtje" • FV Kabell NYM 3x2.5mm2 • FV Tub plastik Ø20mm I kompletuar me aksesore per montim • FV Kuti shperndarese per lidhjet e kablove • Izolim rezistent ndaj zjarrit per hapjet ne mur • Aksesore instalimi • Sirene e brendshme audio vizive • F.V Buton sinjalizimi i zjarrit • F.V Fikese zjarri me pluhur • F.V Tabele dalje emergjence • F.V.Tabele sinjalizimi I emergjences • F.V Tubo ujesjellesi HDPE 100; Ø90 x 5.4, Pn10 	
NS-14 A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione	<ul style="list-style-type: none"> • FV Rack 42HU 800x1000mm duke perfshire te gjithë aksesoret dhe ventilatoret e ftohjes • FV Rack 24 HU 800x800mm duke perfshire te gjithë aksesoret dhe ventilatoret e ftohjes • FV 19" 1U Patch panel 12xRJ45/S Snap-in Cat.6 connector • FV Cat 6 S/FTP RJ45 Patch Cable 1-1,5m • FV Menaxhues Kabllosh Plastik 19" 1U • "FV Blloku elektrik 19"" 1U me 6 shuko individuale dhe 	<p>0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>5,488,987</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • nderpreres qarku" • FV Dalje modulare me priza data 2xCat.6A Shielded RJ45 me te gjithë aksesoret per instalim ne kanalina plastike • FV switch 24 port Gigabit me 2 porta Ethernet/SFP Uplink • FV Kabell NYM 3x2.5mm2 per furnizimin e rack-ut • FV Kabell data Cat.6 F/UTP • FV Fibra Optike 4xFO MM 50/125 • FV Tub plastik Ø20mm • FV Kuti Shperndarese PVC 100x100 mm IP 44 • Izolim rezistent ndaj zjarrit per hapjet ne mur • Aksesore instalimi • FV Kamera ne kuti te fiksuar per rrjet te brendshem, performance ne ndricim te ulet, 1080p, lente 2.8–12mm, WDR, PoE, H.264, PAL, ONVIF, suport I transmetimit te disa videove, e montuar ne tavan ose ne siperfaqe duke perfshire te gjithë aksesoret e montimit • FV Switch PoE 24 port Gigabit me 2 porta Ethernet/SFP Uplink • FV modul SFP • FV 12xSC lidhes fibre optike per Patch panel 19" 1U OF, duke perfshire aksesoret e rregullimit dhe mbajtjes • FV Menaxhues Kabllosh Plastik 19" 1U • FV Patch Kabell Fiber Optike SC/SC 1-1,5m • FV Patch Kabell Fiber Optike LC/SC • FV Kabell data Cat.6 F/UTP • FV Kabell NYM 3x2.5mm2 • FV Tub plastik Ø20mm • "FV Patch Kabell Cat 6 FTP RJ45 per lidhjen nga patch panel • ne celes 1m" • FV Lidhes RJ45 Cat6 tipi FM45 per lidhjen e kamerave • Izolim rezistent ndaj zjarrit per hapjet ne mur • Aksesore instalimi • FV Regjistruer Video ne Rrjet per 16 kamera max. 16, 4TB me konfigurim RAID5, DVD, USB, regjistron H.264/MJPEG/MPEG- 4 IP Streams, suporton kamera nga pale te treta konforme me ONVIF dhe integrim me Stacionin e Menaxhimit te Videos • "FV Bateri dhe Njesi Kontrolli me 3 ore autonomi, kohezgjatje • rikarikimi 12 ore" • FV Amplifikator Audio 2x250W • FV Tuner SD BGM Source • FV Stacion Njoftimi Emergjence • FV Komplet pajisjesh per barrierat ne dalje te parkimit, per gjeresi rrugesh deri ne 2.5 metra te kompletuara me njesi kontrolli, table e ndricuar automatike qe tregon mbushjen e plote te parkimit, fotoqeliza TX-RX dhe loop me 	
--	--	--	--

		<p>induksion per detektim automjetesh dhe sigurie, me te gjithë pjeset e nevojshme dhe aksesoret.</p> <ul style="list-style-type: none"> • "FV Komplet pajisjesh per barrierat ne hyrje te parkimit, per gjeresi rrugesh deri ne 2.5 metra te kompletuara me njesi kontrolli, tabele e ndricuar automatike qe tregon mbushjen e plote te parkimit, fotoqeliza TX-RX dhe loop me induksion per detektim automjetesh dhe sigurie, me te gjithë pjeset e • nevojshme dhe aksesoret." • FV Njesia e Hyrjes ne Objekt (Makineri per Biletat e Parkimit rezistente ndaj vandalizimit dhe ndaj kushteve atmosferike) e pajisur me buton kerkesë per bilete, printer bilete me barcode, mbajtese biletash per kapacitet min. 1000 bileta, menaxhim barrierash dhe hapësire te pershtatshme per te instaluar nje lexues kartash. • FV Njesia e Daljes nga Objekti (Makineri per Biletat e Parkimit rezistente ndaj vandalizimit dhe ndaj kushteve atmosferike) e pajisur me lexues te motorizuar biletash, mbajtese biletash per kapacitet min. 1000 bileta, menaxhim barrierash dhe hapësire te pershtatshme per te instaluar nje lexues kartash. • FV Server Menaxhimi i Parkimit (hardware-i perfshin gjithashtu nderfaqjen ne rrjetin RS485 per kontrollimin dhe monitorimin e te gjithë pajisjeve te sistemit) te ndodhur ne Zyren e Menaxhimit te Sigurise duke perfshire licensen e Sistemit Operativ dhe te gjithë konfigurimet e nevojshme per te qene operacional (Hard Drive duhet te jene ne konfigurim RAID, dual PSU dhe dual Gigabit Ethernet NIC). • FV Desktop PC duke perfshire software POS per operacionet e kashierit, duke perfshire pagesat me kohen e parkimit, leshimi dhe rifreskimi i biletave, menaxhimi i tarifave, etj. Hardware-i duhet te perfshije nje monitor LCD 19"-21", mouse, tastiere, skaner lazer lexues i barcode, Ekran LCD, printer biletash i tipit termik, terheqes kesh, nderfaqe PC me rrjetin RS485, gigabit ethernet NIC per lidhjen me serverin e menaxhimit te parkimit 	
--	--	--	--

N.P-1 A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-2 E (Ndertime civile dhe industriale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtimin e një objekti civil, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-3 C (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasade)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rikonstruksionin e fasadave te disa godinave , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4 B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndertimin e infrastruktures, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.P-4B ku bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

N.P-7 A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per Ujësjiellës, kanalizime, sistem vaditje etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.P-7A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, vepra kullimi e vaditje, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-1 A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje te strukturave te betonit , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me impiantet hidro-termosanitare si sistemi kundra zjarri , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-3 A(Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka vendosjen e ashensorve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e muraturës te godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me sinjalistika ndriçuese në rruge siç janë semaforët, të cilat shtrojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-5A.

N.S-6 A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me sinjalistika në rruge, të cilat shtrojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-6A.

NS-9 D Punime strukturorë speciale

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zbatimin e pilotave me mjete speciale, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-12 B Impiante teknologjike , termike dhe të kondicionimit

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zbatimin e projektit të kondicionimit dhe ventilimit të ambienteve , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka strukturimin e linjave elektrike, telefonike dhe sistemin e kamerave, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-18 A.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e infrastruktures dhe një parkimi nëntokësorë, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S 18A ku është pjesë e rëndësishme punimet topografike.

NS-20 A.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit dhe duke patur parasysh problematikat që mund të hasen nga eksperienca në objekte të mëparshme , i cili lidhet me ndërtimin e infrastruktures dhe një parkimi nëntokësorë, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S 20 A ku është e rëndësishme shpimet gjeologjike për ndërtimin e objektit.

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te percaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas pergjindjes se bashkepunit.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e percakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku percaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

4. Një punësim mesatar i të paktën **140** (njëqind e dyzet) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:
 - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar.
 - b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 140 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 18 muajve kalendarikë, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar N.P –1A, N.P –4B, N.S – 6A, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit dhe arkitektit**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP7 A**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP11 A**, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS 18A**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP 12A** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit te Mjedisit**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kërkuar **NS 3A** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Mekanik**.

6. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikës ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:
 - a) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.
 - b) 2 (dy) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")*.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: *„Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“*.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listëpagesat e

shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- 1 (një) teknik ndertimi;
- 1 (një) Teknik mekanik;
- 2 (dy) punonjes hidraulike;
- 3 (tre) punonjes elektriciste;
- 1 (një) punonjes mekanik;
- 4 (katër) punonjes bojaxhi;
- 3 (tre) punonjes muratorë;
- 1 (nje) punonjës saldator;
- 2 (dy) punonjes pllakashtrues;
- 2 (dy) punonjës hidroizolues;

Punonjes Manovrator (shofer)

- 3 (tre) punonjes eskavatoriste;
- 2 (dy) punonjës buldozerist;
- 2 (dy) punonjës automakinist.

8.1 Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale e punës;
- b) diplomën/dëshminë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore ne Republikën e Shqiperise;
- c) Deshmi Kualifikimi te sigurimit teknik e vlefshme, e cila duhet te jete e lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve;
- d) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

8.2 Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 1 (dy) Teknik ndertimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) teknik mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

2 (dy) punonjes hidraulike prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

3 (tre) punonjes elektriciste prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) punonjës mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

4 (katër) punonjes bojaxhi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

3 (tre) punonjes muratore prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

3 (tre) eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

1 (një) saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

2 (dy) hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

2 (dy) pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

2 (dy) automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

2 (dy) buldozerist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet elektrike, tuba, hidroizolues. Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gënjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilësive etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilësive, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës garanton

Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 dhe kane te bejne me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM Nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 është e lidhur me kerkesat teknike mbi menyren me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.
- e) Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike te pasrashikuara sipas Preventivit.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). Njësia e Prokurimit gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

13. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autovinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vinç kulle deri ne 5 Ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
3	Matrapik	copë	3	Në pronësi ose me qera
4	Trapano	copë	3	Në pronësi ose me qera
5	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Makineri skarifikim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Skreper me V=6-6.5 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Rul me Vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Betonjere 500 l	copë	2	Në pronësi ose me qera
14	Vibrator thellesie	copë	3	Në pronësi ose me qera

15	Vibrator sipërfaqësor	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Eskavator me goma 0.25 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Eskavator me zinxhir me kove 0.50 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Eskavator batipal 1.8 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Elektrosaldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Rul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Fadromë me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Autobot për largimin e ujrave të zeza	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Sondë me fuqi të mjaftueshme për shpim m d=800 mm dhe thellesi nga 0 në 25 m	copë	2	Në pronësi ose me qera
25	Buldozer	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Pompë suvatimi	copë	3	Në pronësi ose me qera
27	Gazogjen	copë	3	Në pronësi ose me qera
28	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -10 Ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
29	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
30	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
31	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 15 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera

- a.** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b.** Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatëse vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Ndodhur në kushtet ku lloji i procedurës së prokurimit është "Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë monetar", mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 56, pika 2 si dhe referuar VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 24, pika 3, Njoftimi i kontratës mbi kufirin e lartë monetar do të botohet edhe në Gazetën zyrtare të Bashkimit Europian.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit gjykon se duhet të parashikohen dhe rastet kur Ofertues janë Operatorë të huaj ekonomik, të cilët duhet t'i paraqesin dokumentat e kërkuara sipas Kriterëve të Përgjithshme dhe Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit sipas formës ligjore të specifikuar në rubrikën Shënim. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Njësia e Prokurimit synon të nxisë konkurrencën midis operatorëve ekonomik dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik (shqiptar ose të huaj) sipas parashikimeve të Nenit 2 të LPP-së.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.